



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Integritet Evropian

Dëgjimi publik nr. 1

Prishtinë, më 22.04.2010, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

i dëgjimit publik të Komisionit për Integritet Evropian

Në dëgjim morën pjesë: Zylfije Hundozi, Džezair Murati, Fatmir Rexhepi.

Munguan: Njomza Emini, Nait Hasani Naser Rugova dhe Petar Miletqi..

Nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale morën pjesë: Sadik Idriz, Vezira Emrush, Flora Brovina,

Me ftesë: Nenad Rasiq- Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Shpend Ahmeti-GAP, Blerim Vela- OSCE, Nysret Shillova- OJQ-“Klubi Dëshira”, Afrim Maliqi-Handikos, Blerim Sylaj-FSSHK, Haxhi Arifi-BSPK, Avni Zuka-NDI, Driton Bajraktari-Down Syndrome, Dardan Sadriu-MIE, Ramadan Islami-GTZ

Për këtë dëgjim u propozua ky

Rend dite:

1. Prezantimi i përmbushjes së sfidave të dala nga Raporti i Progresit për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Zylfije Hundozi pasi Ligji i Punës është kthyer për ripunim në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale është prurë prapë në Parlament në legjislacionin e tretë ku kemi pas një dëgjimi publik me partnerët social megjithatë prapë Fondi Monetar ka reaguar dhe e ka kthyer këtë Ligj për ripunim në MPMS edhe pse ky ligj është hartuar me ekspert

ndërkombëtar, nga organizatat ndërkombëtare të punës. Në një shtet ku ekziston një stabilitet ekonomik i avancuar ai ligj kishte me qenë shumë i mirë dhe i mirëseardhur mirëpo për Kosovën ku papunësia është shumë e madhe me siguri se nuk do ta gjej aplikueshmerin këtu te ne. Kështu që pyetja për ju zotëri Ministër tha është a janë përmirësuar ato vërejtje, a është bërë një harmonizimi i ligjit me buxhetin e Kosovës, a janë përmirësuar vërejtjet prej FMN-së, kur do të vi ligji në Parlament dhe sa ka me qenë i zbatueshëm. Si vërejtje që përmendet në Raportin e Progresit për Ministrinë e juaj tha është puna e fëmijëve. Po ashtu si vërejtje tjetër është trafikimi i fëmijëve andaj ju pyes a keni bërë një koordinim me Ministrin e Punëve të Brendshme sa i përket trafikimit të fëmijëve, a keni bërë ndonjë plan veprimi dhe çka keni ndërmarr në këtë drejtim. Si sfidë tjetër tha është çështja e personave me aftësi të kufizuar. Në Raportin e Progresit përmendet se nuk ka statistika të mirëfillta sa i përket personave me aftësi të kufizuara. Kur nuk ka statistika nuk është e mundur edhe hartimi i strategjisë apo planeve për trajtimin e këtyre personave. Po ashtu si sfidë tjetër është qasja e personave me aftësi të kufizuar sidomos me ato fizike në objektet shkollore. Pyeti a keni paraparë ju ndonjë buxhet apo financim sa i përket qasjes së këtyre personave nëpër shkolla dhe institucione për arsye se analfabetizmi në Kosovë është shumë i madh si për shkolla fillore ashtu edhe për të mesme. Këto janë sfidat të cilat i kemi identifikuar për ministrin e juaj. Tasni tha i jap fjalën Kryetarit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale z. Sadik Idriz të paraqes vërejtjet dhe propozimet e tij.

Sadik Idriz- Kryetar i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, njoftoj se javën e kaluar e kishin ftuar ministrin në Komision për të paraqit disa të dhëna lidhur me përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian. Ai konsideroj se Qeveria dhe Parlamenti së bashku duhet të punojnë dhe ti rumbullakojnë disa gjëra sa i përket sfidave . Konsideroj se Ligji për Punën është ligj mjaft i rëndësishëm por ka implikime buxhetore, por është momenti i fundit që ai ligj të vie në Parlament dhe të miratohet, sepse me Ligjin e Punës janë të ndërlidhura edhe shumë ligje të tjera, si Ligji për Grevat, pastaj Ligji për organizimin sindikal, është e pa mundur të bëhet monitorimi i ligjeve të miratuara, sepse nuk ka ligj për punën.

Sa i përket çështjes së fëmijëve që punojnë punë të rënda dhe trafikimit të fëmijëve duhet të iniciohet një dialog i gjer jo vetëm me Ministrinë e Punës por edhe me Ministrin e Arsimit dhe ministrin tjetër, sepse kjo çështje nuk i takon vetëm ministrisë së punës.

Lidhur me personat me aftësi të kufizuar tha se kemi miratua ligjin për këtë çështje, ku është parapa që në 50 të punësuar të jetë një me aftësi të kufizuar, por tani viteve të fundit ka ndryshu kjo shifër dhe tani ka ra në 25 të punësuar është një i punësuar.

Lidhur me biseksualitetin ende nuk kemi diçka konkrete në këtë drejtim, lidhur me këtë duhet të iniciohet një dialog. Ministria ka bërë përpjekje edhe në këtë drejtim dhe dihet se Kushtetuta e Kosovës në këtë drejtim është mjaft liberale. Në fund tha se do të punojmë bashkë me Komisioni për integritet, do të mbajmë prapë dëgjime dhe takime tjera për të arrit për ti përmbushur sfidat e dala nga Raporti i progresit të Komisionit Evropian.

Ministri Nenad Rashiç theksoi se ministria të cilën e drejton për dallim nga ministrin e tjetër ka përmbushur më së shumti pika sa i përket sfidave të dala nga Raporti i Komisionit Evropian. Një prej sfidave që është cek në Raportin e Progresit është se nuk

është miratuar Ligji për Punën. Ministria e ka hartuar një Ligj të Punës, Fondi Monetar ka reaguar dhe ka ekzistua një pengesë dhe tani ligji në mënyrë figurative është në FMN.

Ai tha se nuk mund të jap sqarime saktësisht se kur do të përfundojë ky ligj, megjithatë është në dijeni se shumë çështje të tjera dhe ligje ndërliken me ligjin në fjalë. “Sa më parë të miratohet ky ligj, për mua do të jetë shumë më lehtë. Më 26 Prill presim që FMN-ja të na e konfirmojë vazhdimin tutje të këtij ligji dhe kjo nuk duhet të zgjas shumë kohë. Shpresoj që gjatë ditëve të ardhshme mund të vazhdojmë punën lidhur me këtë ligj dhe nuk besoj se do të ketë probleme esenciale, duke vlerësuar se ky Ligj do të ketë zgjidhje të qëndrueshme për një kohë të gjatë. Dhe kosto e këtij ligji sillet rreth 1.8 milionë euro brenda vitit. Duke pas parasysh numrin e madh të pa punëve ne duhet tu japim lehtësira punëdhënësve në mënyrë që të arrihet punësimi më i madh, ky ligj ju siguroj tha se do të jetë afatgjatë, pra duhet ta kemi parasysh se punëdhënësit janë për këtë moment mjaft të rëndësishëm.

Në vazhdim të këtij takimi, sa i përket çështjes së fëmijëve që punojnë punë të rënda, Rashiç tha se në Qeveri është miratuar urdhëresa administrative për rregullimin e kësaj çështje, ku në detale është përcaktua kjo çështje dhe është në përputhje me standardet evropiane. Kurse sa i përket çështjes për personat me aftësi të kufizuar, ai tha se që nga muaji qershor i vitit të kaluar, ka filluar ndihma për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar, ka filluar pagesa dhe janë paraqitur më se 3000 familje. Këtyre familjeve u jepen 100 euro në muaj, në mënyrë që të përballojnë më lehtë problemet jetësore.

Kurse sa i përket personave të trafikuar njoftoi se tani janë dy objekte që bëjnë strehimin e personave të trafikuar.

Vlerësoi se ky vit do të jetë vit shumë i rëndësishëm për ministrinë dhe shoqërinë kosovare, ngase përveç këtij ligji pritet edhe hartimi i Ligjit për Pensionet. Do të kemi një ligj të qëndrueshëm i cili do të ofrojë siguri edhe për punëtorët, edhe për punëdhënësit”. Në fund tha se mund të ju dërgoj edhe një raport me shkrim sepse për këtë kohë të shkurtër nuk mund të paraqiten të gjitha çështjet.

Haxhi Arifi tha do e nisi siç thotë një këngë që këndohet këtu në Kosovë “Krejt mbrapsht”. Shtoi është duke u dhënë një vullnet, është duke u bërë një punë por nuk është duke u bërë një punë në rrugën të cilën duhet bërë. Nëse ne nuk e kemi një ligj të punës se di se çka mund të bëjmë me tjerat ligje. Faktikisht ne tha po e ndërtojmë shtëpinë nga kulmi e jo nga themeli. Ligji për Sindikatat e për Grevat duhet ta ketë bazën në ligjin e Punës. Nëse Ministri deshi ti mbroj punë-dhënësit edhe ne dëshirojmë ti mbrojmë punëtorët dhe ne punëtorët i mbrojmë me djersën tonë dhe japim kontributin tonë. Ne nuk kërkojmë nga ata atë që nuk na takon, por së pari kërkojmë nga Qeveria gjegjësisht nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ta nxjerr këtë ligj, sepse ky ligj do ti disiplinoj edhe punëdhënësit në këtë rast sektorin individual ku janë të punësuar mbi 250 mijë punëtor dhe ku atje bëhet diskriminimi më i madh. Duke filluar nga mungesa e kontratave, orari i punës, mungesa e mbrojtjes në punë, sigurimeve shëndetësore. Punëdhënësit kur ti tekton flak nga vendi i punës punëtorin. Për këtë është Ligji i Punës më se i duhur dhe kostoja e atij ligji nuk është e pa përballueshme për Qeverinë. Nga ky mos miratim i ligjit sektori individual ku janë të punësuar 80%, shtetit nuk i paguhet tatimi. Në këtë shtet duhet të sundoj ligji të mos kemi askënd mbi ligjin ndërsa në këtë rast kemi njerëz mbi ligjin. Ai ligj nuk ka pasur pengesa edhe më herët sepse ne kemi biseduar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar jo një herë por disa herë dhe ata

preferojnë, ata nuk bëjnë pengesa, pengesa jemi na vetë. Nuk e di dhe më intereson të di prej Ministrit ku janë pengesat sepse dëshirojmë të dimë nga dora e parë. Nëse janë pengesat në Qeveri, ju jeni në Qeveri aty. Andaj prezantoni ju lutem. Sa i përket dialogut social tha nuk kemi dialog social në Kosovë. Këshilli Ekonomiko- Social nuk funksionon. Punëdhënësi dhe punëmarrësi janë ata mekanizmat kryesorë, Qeveria është monitoruese aty. Ky Këshilli Ekonomiko- Social është për ti dhënë këshilla diku. Në shtetet më demokratike ekzistojnë Këshillat Ekonomiko- Social por duke u thirrur në rregullativa. Edhe këtu është tejkaluar vendimi i Qeverisë i nënshkruar nga Kryeministri për Këshillin Ekonomiko- Social dhe aty nuk respektohen kriteret e atij vendimi të Qeverisë. Unë e di se Ministri do të më replikoj por e vërteta është kjo. Duhet të na bindin me argumente jo me fjalë sepse edhe Raport i Progresit ka thënë disa fjalë por edhe tani kur ishim në Bruksel. Ministri duhet me ditë se kush duhet të shkoj në Bruksel e kush jo nga OJQ-të e jo këta ti caktojnë njerëzit të cilët këta i dëshirojnë.

Kryesuesja kërkoi që të kufizohet debati në 5 minuta. Replikë tha ka kërkuar Ministri.

Ministri Nenad Rashiç replikoi duke thënë se askush në Qeveri nuk po e shtyn miratimin e Ligjit për Punën, vështirësi teknike ka, por ministria po bënë përpjekje që të paraqes një Ligj të qëndrueshëm dhe të praqes siguri për të ardhmen për të drejtat e punëtorëve dhe tha se duhet të kihet parasysh se duhet ti tërheqim investitorët, sepse në Kosovë është pa punësi e madhe dhe se Kosova nuk ka kapacitete për këtë numër të madh të pa punëve.

Menjëherë pas emërimit të tij tha se e kishte funksionalizuar Këshillin tri palësh i cili në përbërje ka 5 përfaqësues të punëdhënësve, 5 nga sindikata dhe 5 nga Qeveria, ku edhe vet Haxhi Arifi tha se ka qen i ftuar të merë pjesë në takimin kur kemi diskutuar për kontratën kolektive. Unë i mbroj interesat e ministrisë me çdo kusht dhe po ashtu kërkoj nga të gjithë ti mbrojnë interesat e atyre që i përfaqësojnë.

Haxhi Arifi unë tha duhet ti them para juve Ministrit se edhe ne si punëtor jemi të kulturuar dhe e themi fjalën e vërtet e jo gënjeshtren. Nuk është e vërtet se sipas kriterit të Qeverisë janë nxjerr partnerët për Këshilli Ekonomiko- Social. Do t'ua dërgoj të gjithëve vendimin e Qeverisë. Edhe konferencën kur e ka thirrur Ministri në vend që ti thërret tri palët nuk kanë pasur guximin as herën e parë as të dytën ti thërras përfaqësuesit nga BSPK. Këta i kanë emëruar sipas tekeve dhe jashtë vendimit të Qeverisë. Kjo është mase e vërtet dhe do t'ua prezantoj të gjithëve materialin dhe pesë kriteret të cilat janë dhe që BSPK-ja i plotëson 100% ndërsa pala tjetër të cilët këta i kanë prurë nuk i plotësojnë. E ka thënë edhe Kryetari i Odës Ekonomike nuk është prioritet për mua Këshilli Ekonomiko- Social dhe u pa pse nuk është prioritet. Andaj BSPK-ja e ka vendin me pesë anëtar sepse i plotësoj kushtet 100%. Katër janë shqiptar dhe një nga komuniteti. Andaj të tjerët janë fut por ai Këshilli Ekonomiko- Social kurrë nuk do të jetë funksional pa punëtorinë kosovare. Këta e kanë mundësin me e shkel vendimin e vetë dhe të Qeverisë së vetë e të Kryeministrit, le ta shkelin por ne nuk do të jemi aty. Ne para dy viteve e kemi përmend pagën minimale kur dikush nuk ka ditë çka është paga minimale. Po ju garantoj se ata njerëz të caktuar nuk e dinë se çka është dialogu social. Për dialog social duhet me u shkolluar. Unë e argumentoj dhe jap përgjegjësi për këtë që po them. Keni bërë kompromis me Oden Ekonomike në takimin që keni pasur në Maqedoni atëherë e keni

ndërruar vendimin dhe ja keni dhënë katër anëtar Odës sepse ata i kanë pasur tre. Të ne nuk ka kompromise te ne nuk ka pazare, ne nuk jemi treg. Ne kërkojmë të drejtën tonë që na takon me vendimin e Qeverisë. Kemi anëtarësinë që e paguajnë, kriteri i parë, e kemi kriterin e dytë që jemi anëtar të Sindikatave Botërore e Evropiane, i kemi kontratat në nivel nacional dhe e kemi Komisionin për shqyrtimin e Arbitrazhit ndërsa partneri tjetër që këta e kanë caktuar nuk i ka.

Dzezair Murati konsideroi se kur është në pyetje numri i madh i ligjeve duhet bërë prioriteti i tyre, ka lëvizje në këtë drejtim, por është edhe lista e gjatë e prioritetëve dhe konsideroj se Ligji për Punën dhe Ligji për Sigurimet Shëndetësore janë prioritare. Tha e kuptoj zhgënjimin e z. Arifit por tha se ne të gjithë kemi përgjegjësi të përcaktuar, por ne përfaqësuesit e popullit kemi përgjegjësi morale. Në vazhdim vlerësoi punën e Komisionit për Integritet Evropian në kuadër të kompetencave që ka si mjaft aktiv dhe nëse vazhdohet me këtë tempo të punës dhe mirëkuptimit me ministrat e resoreve do të arrijnë të përmbushim atë çka pret nga ne bashkësia ndërkombëtare. Në fund e përmbylli diskutimin me vlerësimin se me miratimin e Ligjit për punë do të arrihet të zgjidhet nyja për miratimin edhe të shumë ligjeve tjera.

Shpend Ahmeti tha kam kënaqësinë që sot të diskutojmë për dy apo tri tema të Raportit të Progresit që te ne është bërë praktik të diskutohen pasi që të publikohet e pastaj të harrohet për një kohë të gjatë. Shtoi fatkeqësisht në këtë kohë për ne thuaj se është përgatitur drafti i parë i Raportit të Progresit për këtë vit që është një procedurë që zgjatë gjashtë muaj dhe si duket do ta kemi një vlerësim të njëjtë të situatës, nëse nuk është edhe më i keq se vitin e kaluar për shumë aspekte. Temat për të cilat do të diskutojmë Ligji i Punës dhe sfidat në implementimin e ligjit të punës do të ishim gëzuar sikur të ishte punuar dhe të mos e diskutojmë por siç e ceku edhe deputeti Murati drafti i ligjit është përgatitur që nga themelimi i institucioneve tona dhe prej atëherë zhagitet dhe gjithmonë me arsyetimin që është FMN. Ky arsyetim ka qenë edhe atëherë kur nuk ka qenë Kosova anëtare e tij. Fatkeqësisht ministri Rasiq në konferencën e donatorëve ka kërkuar falje paraprakisht që po kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe rritje të të drejtave të punëtorëve dhe pagave. Nuk e fajësoj zotëri Rashiqin por ky relacion me bashkësinë ndërkombëtare gjithmonë është krijuar kështu. Bashkësia ndërkombëtare gjithmonë mendon kështu për kosovarët, po ti lëmë ti kalojnë të gjitha këto ligje të cilat ata po dëshirojnë posaçërisht në aspektin social, Kosova do të bankrotonte brenda një viti sepse nuk është puna te Ligji i Punës por te Ligji për Sigurime Shëndetësore e pastaj Ligjin për Sigurime Pensionale. Krejt këto kanë kosto shumë të madhe prandaj më mirë është mos të kaloj as një ligj sesa me ja u qel derën tan këtyre ligjeve. Ku qëndron arsyetimi në raport me FMN a është që ne duhet të kërkojmë lejen prej tyre për koston buxhetore për 1.8 milion euro në vit ndërsa të njëjtën leje se kërkojnë për autostradën që kushton 630 milion euro dhe fatkeqësisht FMN na kërcënon se do të ndërpresë marrëveshjen me ne, Banka Botërore kërkon që të tërhiqet me financimin e tyre prej 60 milion eurosh dhe Komisioni Evropian kërcënon se në qoftë se nuk dëgjojnë FMN edhe ata do të tërheqin ndihmën e tyre. Për autostradën, 630 milion euro ndërsa për 1.8 milion euro në vit na qenka problem prandaj ky arsyetimi Qeverisë në këtë aspekt nuk qëndron, sepse ja po e përcjellim FMN në të gjitha fushat ja nuk do ta përcjellim në mënyrë selektive. Në një vend ku papunësia është më shumë se 40% bilanci i fuqisë gjithmonë është te

punëdhënësi për arsye shumë të thjeshta, për çdo vend pune nëse largohet një punëtori ke dhjetë vetë në rend që presin me nxënë atë vend të punës, dhe natyrisht punëdhënësi ka fuqi enorme jo me qitë prej punës, mos me bo kontratën, mos me ja paguar tatimin, mos me ja paguar pensionet dhe pikërisht këtu qëndron problemi që institucionet duhet të kishin një rol më të madh. Vetë ministri Rasiq e përmendi se vetëm 250 mijë persona i kemi të regjistruar si të punësuar dhe prej tyre vetëm nëpër institucionet e vendit që nuk kanë mundësi pa i lajmëruar. Ndërsa të tjerët janë të lajmëruar por janë gjithmonë të lajmëruar me rroga më të ulta se që i marrin realisht. Pra ne kemi problem me ekonominë informale nuk e kemi problem me taksa sepse i kemi taksat më të ultat në regjion. Jemi i vetmi shtet në regjion që nuk e kemi Ligjin për Sigurime Shëndetësore. Fatkeqësisht nuk është kalimi i ligjit e vetmja sfidë, ju e dini edhe në Raportin e Progresit ku nuk shkruan që kalimi i ligjit është sfida por shkruan implementimi i kornizës ligjore sepse deri në fund të prillit do ta kalojmë ligjin e punës por mandej prapë do ti diskutojmë të njëjtat gjëra.

Flora Brovina tha në këtë lami për të cilën po diskutojmë këto çështje janë të nënvizuara me vij të kuqe si mungesa e Ligjit të Punës, mungesa e Ligjit për Pensionet, mungesa e zbatimit të ligjeve dhe kjo është një pengesë shumë e madhe. Kur debatuar për Ligjin për Greva ne si komision kemi bërë presion që Ligji i Punës të vij i pari por edhe unë edhe pse i takoj partisë në pushtet nuk kam votuar për Ligjin për Organizimin e Grevave sepse mungon Ligji i Punës. Pra kemi qenë unanim që ligji i punës të vij i pari. Kam shumë arsye kur flas kështu sepse ligjet që dalin nga ky ligj bazik nuk mund të zbatohen si të tilla. Shembull tha komisioni ynë ka bërë grupin punues për monitorimin e ligjit të Inspeksionit të Punës dhe ndër elementet e para janë orari i punës, mos zbatimi i shumë gjërave tjera për shkak se nuk ekziston Ligji i Punës. Ligji për Inspeksionin është ligji i parë i aprovuar nga Parlamenti në mandatin e parë pra një ligj që është vështirë i zbatueshëm. Edhe ligjet e tjera siç është ligji për arsimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara që hyn në kuadër të integritimeve evropiane nuk po gjen zbatim sepse nuk është inkorporuar me ligjin e punës. Ekziston Ligji për Ushqimin e Foshnjave e që është obligim ligjor për nënat ushqyeshmëria e fëmijës deri në muajin e nëntë por si mund të aplikohet ky ligj kur nënat kanë pushim vetëm tre muaj. Pra edhe shumë ligje të cilat janë aprovuar në Kuvendin e Kosovës nuk janë në relacion me një ligj tjetër që është ligji i punës. Kemi kërkuar që edhe dialogu social të hyj në programin e punës sonë dhe kemi vërejtur se dialogu social nuk funksionon apo Këshilli Social nuk funksionon. Sindikatat kanë arsye shumë të forta që të kërkojnë dialog social dhe uroj që edhe ju të uleni bashkë me ta që ta ndërtoni dialogun. Sigurisht ai Këshill nuk i plotëson kushtet sepse nuk e ka edhe ligjin bazik, e dyta në këtë Këshill mungon zbatimi i ligjit për barazi gjinore e që është kusht edhe për integritime evropiane. Kisha dashur të ju them atyre që ju takon e jo juve z.Ministër jo vetëm për shkak të buxhetit do të viheshim kushte të tilla sepse kjo mbulon mandej edhe shumë çështje të tjera por edhe për shkak të privatizimit sepse për dhjetë vjet neve nuk patëm investime e se patëm ligjin kjo është diçka shumë interesant dhe kujtoj që kur të kryhet privatizimi, ligji do të vij shumë lehtë. E kjo ka kuptim shumë më shumë se deri më tash.

Afrim Maliqi sa i përket të gjeturave të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian ku përmenden statistikën ajo është e vërtetë. Kemi raporte se ekzistojnë kaq apo aq të rritur

dhe fëmijë me aftësi të kufizuar por fatkeqësisht kjo do të mësohet kur të filloj regjistrimi i popullsisë i cili pritet të bëhet për gjithë popullatën e Kosovës, por kjo nuk do të thotë që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të mos ketë një shifër dhe një numër të përafërt të njerëzve me aftësi të kufizuara. Ajo çka është dhe që e tha edhe Ministri rreth përkrahjes sociale për familjet me personat me aftësi të kufizuar, është e vërtetë që janë duke ju dhënë ato mjete dhe ju ndihmon familjeve por fatkeqësisht llogaritet se sipas këtij ligji po financohen vetëm 3 mijë familje ndërsa janë edhe 27 mijë familje të cilët nuk e gëzojnë këtë mbështetje. Në anën tjetër nuk po përmendet këtu e që është ndihma me pajisje për personat me aftësi të kufizuar e që në Kosovë mungon. Nuk ka as një shtet në rajon që u ofrohen paisje për këta persona vetëm prej OJQ-ve. Kjo çështje është barrë e MPMS dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Në anën tjetër u përmend edhe ligji i punësimit të personave me aftësi të kufizuara, nëse fillon edhe ky ligj me u implementuar edhe pse nuk është hartuar ashtu siç kemi menduar ne, ku parasheh përkrahjen materiale prej moshës 18 deri 30 vjeçare ajo ndikon në destimulimin e punëkërkuësve njerëz me aftësi të kufizuar për arsye se njerëzit që gëzojnë atë pension nuk kanë të drejtë të punësohen. Ka edhe shumë çështje tjera, por MPMS duhet të tregoj një gatishmëri shumë më të madhe për bashkëpunim me OJQ-të. Po ashtu në Raportin e Progresit potencohet që Qeveria nuk konsultohet me organizatat jo qeveritare dhe nuk ka bërë asgjë rreth riaktivizimit të Këshillit Nacional mbi Aftësinë e Kufizuar përveç vitit të kaluar që ishte mbajtur një takim dhe asgjë më shumë.

Fatmir Rexhepi tha qëndrojnë vërejtjet e dala nga Raporti i Progresit jo vetëm në këtë fushë që ka të bëjë me sfidat dhe detyrat që i dalin institucioneve të vendit të cilat janë të mëdhaja por ne kemi alarme për krimin, korrupsionin për shkallën e lartë që është i pranishëm në Kosovë dhe i cili do të determinoj pastaj zhvillimet e ndryshme në këta sektorë. Këtu matemi dhe është pasqyra reale e jona si Parlament, si institucione, si Qeveri, mendoj që jemi larg. Me ato politika të cilat nuk kemi gjetur asnjëherë kohë dhe vazhdojmë pas shpalljes së pavarësisë mungon debate në parlament, të jemi korrekt para shoqërisë së Kosovës si parlamentar si njerëz jo për të qortuar Qeverinë por për të parë relaisht se cilat janë prioritetet dhe detyrat e para që duhet ti përmbushim. Unë mendoj që vazhdon njësoj të mos kemi debat qoftë për politikat ekonomike, sociale, punësimit dhe të varfërisë dhe për të gjitha të tjerat të cilat me gjithë atë do ti jepnin një orientim një alternative Qeverisë që të mat gjendjen aktuale dhe të sheh alternativat për të ndryshuar të ardhmen. Mendoj se do të na kushtoj dukshëm në përmbushjen e këtyre standardeve dhe detyrave të cilat po i lëmë në mëshirën e një ministri apo kohës për të parë se si po ecin. Unë po ashtu ndaj vlerësimin me ju për implementimin jo të këtyre projektligjeve aktuale por edhe të atyre me prioritet që janë në Kuvend. Pra është e kotë të bësh zhurmë në Parlament qoftë si herën e fundit që ishte për ligjin për grevat por edhe të tjerat. Ne i ngrisim shqetësimet dhe i ndajmë opinionet tona edhe në këtë tryezë lidhur me ato se si duhet të instalojmë dhe ti adresojmë politikat që na takojnë si parlament si Qeveri si shoqëri dhe mendoj që duhet në Parlament me prioritet të vendosen politikat për shfrytëzimin e fondeve, politikat e investimeve kapitale, milionave që na rrinë jashtë. Askush nuk i llogarit këto dhe pastaj na vjen problem që është edhe këtu a e mshefim një punëtor një firmë apo se mshef. Ku janë ato fonde pse nuk investohen në Kosovë, si do të rriten vende të reja të punës këto janë tema dhe debate që duhet ti bëjmë e pastaj është reale ligji, implementim dhe mbrojtja e të drejtave të punëtorëve që ju takon. Pra një

përmbushje e një standardi që ju takon në synimin që kemi, që të jemi shoqëri ekuivalente me shoqërinë në Evropë. Pra ne nuk po i vendosim politikat, prioritetet por po i lëmë në mëshirën e asaj që nuk i dimë. Në qoftë se i lëmë cilin do ministër, ministri, Qeveri të bëjë marrëveshje dhe të na futë në borxhe me miliarda e të mos dijë askush në Kosovë atëherë shtrohet pyetja cili është roli i këtij Parlamenti dhe çka po ndodh me jetën tonë politike me prosperitetin tonë zhvillimor. A mund dikush këtë ta ngrit dhe ta sheh në Parlament. Jo. Mas akteve të kryera pasojat do të jenë të mëdha. Pra me paratë tona që i kemi nuk i shfrytëzojmë për zhvillim, futemi në borxhe që se di kush, bëjmë projekte të mëdha që se di kush sa është vlera, sa është kontrata, sillemi sikur kjo shoqëri të mos kishte as inzhinjer, as arkitekt, as jurist, as parlamentar, as qeveritar edhe dalim e krenohemi se hymë në histori hymë në letra, a fëmijët tanë kemi me i lënë në borxhe. Si deputet mendoj se e kemi hup hapin dhe nuk jemi ka i përmbushim këto standarde dhe kriteret dhe do ta kemi shumë vështirë mos hapjen e debateve kryesore në Parlament për tema të caktuar që të gjinden zgjidhjet e mundshme në kohën e mundshme. Ne mendoj se nuk i kemi kushtuar rëndësi andaj e ndaj mendimin me kolegët që ne duhet të bëjmë përpjekje si parlamentar, unë personalisht do të jem i angazhuar edhe në kuadër të Grupit Parlamentar edhe si njeri si individ por mendoj pak më ndryshe nga kjo që po zhvillojnë politiken nëse do të mund të bëjë një gram do të mundohem nëse jo.

Vezira Emrush theksoi se sot të gjithë e kemi një sfidë para vetit, sepse Komisioni Evropian na jep detyra çdo gjashtë muaj dhe nëse nuk i kryejmë detyrat atëherë dihen pasojat. Esenciale e konsideroj ligjin për punën dhe për këtë fajësoj Qeverinë sepse tani tha jemi shtet që dy vite dhe është dashtë të fillohet nga Ligji i punës, Ligji për Pensionet, pastaj Ligji për Sigurimet Shëndetësore si dhe Ligji për Privatizimin. Ne jemi shtet në tranzicion është dashtë ta bëjmë analizën sociale dhe ekonomike dhe të analizojmë se si shtetet që kanë kaluar tranzicionin, kanë arritë të përmbushin këto obligime. Në fund apeloj se është koha e fundit të vi Ligji për Punën sepse ligji rregullon raportin mes punëdhënësit, Qeverisë dhe punëtorëve dhe duhet të kemi kujdes se kemi nepotizëm të madh në këtë aspekt. Nuk mund të arrihet dialogu social pa ligj, nuk është e vërtetë që na kalojnë investitorët, por pa ligj i cili rregullon obligimet dhe detyrat e punëdhënëseve dhe të drejtat e punëtorëve nuk vijnë investitorët, potencoj se këtë çështje duhet ta vejme si pikë të veçantë në rendin e ditës në seancë sepse ne duhet ta ngrijmë zërin sepse janë në pyetje të drejtat e punëtorëve tanë. Apeloj në ministrin të përshpejtoj miratimin e Ligjit për Punë sepse nga kontributet e punëtorëve të formohet një fond pensional, jo siç e kemi tani Trustin Pensional i cili është privat dhe e i ka dëmtuar të punësuarit me miliona euro, pastaj çështja e pushimit të lehonave nuk është e rregulluar, është tre muaj.

Blerim Sylja më ka ra në sy që thotë se sindikatat nuk janë aktive në dialogun social. Unë nuk e di se sa Qeveria e kupton dialogun social me të vërtetë. Pyetja ime e parë kishte me qenë për Ministrin edhe pse e di se s'ka me ditë me mu përgjigj. Fondi Monetar Ndërkombëtar a i ka thirr këta për Ligjin për punën, Grevat dhe Sigurimet Shëndetësore apo për këto investime në rrugë. Sepse është paradoks me të thirr me shku për ligjin për punën që është ligj elementar edhe me të gjitha konventat ndërkombëtare, pra unë për vetë nuk jam ka e kuptoj. Sa i përket të drejtave edhe unë nuk mundem me iu përzier kryetarit sepse hynë në kuadër të sindikatës. Ju premtoj se nëse cenohen të drejtat e

punëtorëve me siguri kemi me qenë shumë unik dhe do të jemi në fjalën tonë që do të jemi shumë sindikat radikale. Unë i kuptoj investimet e huaja duhen me u thithë në Kosovë por e tha edhe doktoresha unë nuk di çfarë investimesh kërkojnë ata kur ne nuk kemi pas hiq. Ministri duhet të dijë që ligji do të dal me siguri por implementimi i atij ligji sa do të jetë efektiv. Nuk e kanë të qartë zotërit në Qeveri se për me u formuar një specialist apo motër medicinave i duhën minimumi dhjetë vjet. Sot në Kosovë të ndodh që vjen një drejtor i partive të ndryshme edhe thotë të qes prej pune, se të tjerët po presin plot në rend. Këtë deri sa jemi ne bashkë nuk do ta lejojmë sepse nuk jemi as Tunguzi as prej Afrikës. Sa i përket femrave tha 70% në Sindikatë tek unë janë femra. Nuk është e vërtet që janë ka paguhen 6 muaj ditë, janë ka paguhen vetëm 3 muaj ditë. Ne kemi marr qëndrim dhe kemi bërë draftin ku kemi kërkuar që të jetë 12 muaj dhe kemi qenë konciz se sa duhet të paguaj shteti dhe sa punëdhënësi. Por Kosova po i krijon probleme sociale vetë vetës për këtë të jeni të bindur. Në Kosovë duke u shkelur punëtori na lindin më shumë fëmijë tek familjet që janë raste sociale sesa te ato familje që mund të kujdesen për fëmijë. Andaj gjithmonë duke menduar për shtetin dhe popullin tim ju kisha lutur që në ligj tu epet një hapësirë më e madhe të drejtave të punëtorëve sepse ai punëtor ka me u përgjigj nëse punëdhënësi i krijon kushte.

Zylfije Hundozi faleminderit unë e kisha lutur ministrin nëse ka me përmbledh diçka nga ky diskutim, nëse nuk ka diskutues e përmbylli këtë diskutim. E lus ministrin që të paraqes raport me shkrim për shkak se komisioni duhet të raportoj për këtë në seancë plenare.

Dëgjimi përfundoi në ora 11:50min.